



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1322/1 Prot.

Durrës, më 06.10.2021

**VENDIM**

Nr. 58, datë 06.10 2021

**"Për miratimin paraprak të Planit Buxhetor Afatmesëm për periudhën  
2022-2024, për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10 296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 "Përmiratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Udhëzimin e Përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 të Ministrisë të Arsimit, Rinisë dhe Sportit, dhe Ministrisë të Financës dhe Ekonomisë "Mbi skemën e zbatimit të modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, propozimeve të përcjella nga Fakulteti i Biznesit me shkresën prot.nr., 966/1 datë 21.07.2021, Fakulteti i Edukimit me shkresën prot.nr.966/3 datë 28.07.2021, Fakulteti i Studimeve Profesionale me shkresën prot.nr.966/4 datë 28.07.2021, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike datë 27.08.2021, për përgatitjen e Planit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2022-2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.10. 2021,

**VENDOSI:**

1. Miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm për periudhën 2022-2024, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës sipas formularëve të ankesit 7-A, bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe i kalon Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Ksënela SOTIROESKI**

